



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 120/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, për shkak të Shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, gjatë Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**PRANOHET** si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova, dhe subjektit politik Lista Serbe, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 25,000.00 (njëzet e pesë mijë) euro, për shkak të shkeljes së kodit të mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, e cila detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

## **A r s y e t i m**

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova me të cilën pretendon se subjekti politik Lista Serbe ka publikuar një spot zgjedhor ku bënë mesazhe kërcënuese për mos krijimin e ushtrisë së Kosovës dhe funksionalizimin e plotë të shtetit të Kosovës. Në spot gjithashtu bëhet thirrje për ruajtje e institucioneve të Serbisë në Kosovë ndërsa Kosova quhet Kosova dhe Metohi. Pra parashtruesi i ankesës thekson se spoti i Listës Serbe ka mesazhe që nxisin provokim dhe urrejtje ndaj ekzistencës të shtetit të Kosovës dhe janë në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesës si provë materiale ka bashkangjitur një CD.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik Lista Srpska për ankesën që është bërë ndaj saj dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës në fjalë deri më datë 08.06.2017 deri në ora 09:00.

Subjekti politik Lista Srpska gjer në ora 11:00 të datës 08.06.2017 nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë. Mos dorëzimi i përgjigjes në ankesë si dhe mos dorëzimi i saj me kohë, nuk është pengesë që PZAP-i të vendos lidhur me ankesën (neni 7.5 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it).

PZAP-i pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se;

**- ankesa është e bazuar**

Paneli pas shikimit të bërë në CD-në, e ofruar si provë materiale e cila është publikuar edhe në web-faqe zyrtare të Listës Serbe, ka vlerësuar se subjekti politik Lista Serbe me qëllim të promovimit të subjektit politik dhe kandidateve të tij në spotin zgjedhor Lista Serbe ka përdorur simbolet e hartës të Serbisë ku është përfshirë edhe Kosova, që nxit urrejtje, bënë kërcënim për mos krijimin Ushtrisë së Kosovës dhe funksionalizimin e shtetit të Kosovës. Spoti Lista Serbe po ashtu ka mesazhe që nxit provokon urrejtjen ndaj ekzistimit të Shtetit të Kosovës dhe bënë thirrje për ruajtjen e institucioneve të Serbisë në Kosovë, ndërsa Kosovën e quan Kosova i Metohija, poashtu nga spoti në fjalë sipas Listës Serbe është e vetmja listë që i ka kandidatët serbë për deputetët serbë, e që edhe kjo është një fyerje për subjektet tjera politike serbe, sepse siç dihet janë të certifikuar edhe subjekte politike tjera te këtij komuniteti dhe të njëjtat janë duke garuar në zgjedhjet e parakohshme parlamentare për Kuvend në Republikën e Kosovës, dhe sipas vlerësimit të Panelit me përdorimin e kësaj gjuhe në spot nxitet urrejtja kundër të tjerëve.

Më këtë rast, PZAP-i, vlerëson se subjekti politik i lartpërmendur ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika (l) të LZP-së, e cila dispozitë ligjore përcakton: *Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: Përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon , ose që mund të nxisë ose provokoj një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materialit tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.*

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi mori parasysh shkeljet e lartpërmendura, dhe shqiptoj gjobën, duke u bazuar në nenin 120 par. 1 pika (c) LZP-së, nenin 3 pika 11 Rregullores për Nr.01/2012, për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it, si dhe duke marr parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;

- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.120/2017 më datën 08.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

Hasan Shala



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.